VENDIM
Nr. 1182, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË LËSHIMIT TË AKTEVE TË KALIMIT NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË TOKËS BUJQËSORE DHE TË MODELIT TË AKTIT INDIVIDUAL TË KALIMIT NË PRONËSI TË TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 14, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kalimi në pronësi, pa shpërblim, për tokën bujqësore në përdorim do të kryhet nga ASHK-ja për:

a) kërkesat e patrajtuara dhe të refuzuara, për shkak moslegjitimimi, që janë paraqitur pranë organeve kompetente, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të shfuqizuar, dhe të ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të shfuqizuar. Përjashtim këtu bën rasti kur refuzimi i kërkesës, për shkak moslegjitimimi është konfirmuar nga një vendim gjykate i formës së prerë;

b) kërkesat që janë paraqitur pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, brenda afatit 6-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";

c) kërkesat që mbështeten në një vendim gjykate të formës së prerë, që detyronte institucionet ligjzbatuese të kohës të pajisnin subjektin me tokë bujqësore;

ç) kërkesat që kanë për objekt kalimin në pronësi të parcelave, të cilat pavarësisht se nuk janë pasqyruar në aktin e marrjes së tokës në pronësi që disponohet nga subjekti, përdoren nga ky i fundit.

2. Në procesin e kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, ASHK-ja u referohet rregullave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

3. Në përmbushje të qëllimeve të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të gjitha institucionet kanë detyrimin të dorëzojnë arkivat dhe dokumentacionin përkatës për reformën agrare para vitit 1946, për dhënien në përdorim dhe pronësi të tokës bujqësore, përfshirë hartat dhe regjistrat e kadastrës së tokës bujqësore, për verifikimin e titujve të tokës bujqësore dhe çdo dokument që ka lidhje me to. Nëse ky detyrim nuk është përmbushur ende, dorëzimi i dokumentacionit pranë ASHK-së duhet të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

II. KUSHTET DHE PROCEDURA PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË TOKËS BUJQËSORE

4. Kushtet që duhet të plotësohen për kalimin në pronësi të tokës bujqësore në përdorim janë, si më poshtë vijon:

4.1 Kushtet që duhet të plotësohen nga subjekti për kalimin në pronësi të tokës bujqësore:

a) Do të përfitojë kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, sipas kushteve të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", subjekti që:

i. ka qenë anëtar i ish-kooperativës bujqësore dhe banor i fshatit në përbërje të ish-kooperativës bujqësore në datën 1.8.1991;

ii. ka qenë banor i fshatit në përbërje të ish-kooperativës bujqësore në datën 1.8.1991, pavarësisht se nuk ka qenë anëtar i saj;

iii. ka qenë anëtar themelues i ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore dhe banonte në territorin e tyre në datën 1.10.1992;

iv. ka qenë punonjës i ish-ndërmarrjes bujqësore në datën 1.8.1991;

v. ka përfituar nga e drejta sipas neneve 5 e 6, të ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar, dhe që ishin subjekt të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën";

vi. është zhvendosur nga qendra e tij e banimit për në territoret e ish-ndërmarrjes bujqësore me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit janë edhe përfitues të tokës bujqësore në pronësi;

vii. është ose janë trashëgimtarë ligjorë të personit, toka e të cilit është marrë gjatë reformës agrare, për krijimin e ish-kooperativave bujqësore dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, pavarësisht vendbanimit të tyre, në kohën e paraqitjes së kërkesës, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni kadastral i strukturës së administrimit dhe menaxhimit të tokës (DAMT/ZAMT) dhe, konkretisht, dokumentet në të cilat evidentohen pronësia private apo shtetërore, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 108, datë 29.8.1945, "Për reformën agrare", siç janë listëpronësitë, regjistrat apo çdo arkiv tjetër, nga ku rezultojnë të dhëna të tilla.

Për përmbushjen e kushteve sipas nënndarjeve "i" deri "vi", drejtoria vendore e ASHK-së shqyrton listën e kryefamiljarëve dhe gjendjen familjare të datës 1.8.1991 apo listën që është disponuar gjatë ndarjes së tokës bujqësore, librin e ngastrave të fshatit, listën e familjeve anëtare të ish-kooperativës/ish-ndërmarrjes bujqësore, si dhe çdo dokument, i cili ka të dhëna mbi procesin e ndarjes së tokës bujqësore. Vendbanimi dhe gjendja familjare, sipas periudhave të përcaktuara në nënndarjet "i" deri "vi" të kësaj pike, vërtetohet nëpërmjet certifikatës së gjendjes familjare të subjektit kërkues. Nëse nuk vërtetohet legjitimiteti i kërkuesit sipas nënndarjeve "i" deri "vi", atëherë ky i fundit mund të depozitojë pranë ASHK-së:

- vërtetimin nga sigurimet shoqërore që ai ka qenë punonjës i ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore; ose

- vendimin e gjykatës që provon se ka qenë punonjës i ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore; ose

- vendimin e gjykatës që provon të drejtën e tij dhe anëtarëve të familjes për të përfituar tokë bujqësore.

b) Subjekti, që ka paraqitur kërkesë për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, nuk duhet të ketë përfituar tokë bujqësore në territorin e ndonjë ish-kooperative apo ish-ndërmarrjeje bujqësore tjetër. Për vlerësimin e këtij kushti, ASHK-ja shqyrton dokumentacionin e administruar nga struktura e kadastrës së rrethit, referuar vendbanimit në datën 1.8.1991 dhe vendbanimit aktual, në raport me vendndodhjen e pronave për të cilat subjekti kërkon të pajiset me aktin e marrjes së tokës në pronësi.

Dokumentacioni dhe të dhënat që shqyrtohen nga ASHK-ja për këtë qëllim janë:

i. vendimet e komisioneve të tokës të rretheve që kanë përcaktuar fshatrat e ish-kooperativave bujqësore;

ii. librat e ngastrave bujqësore të fshatrave;

iii. librat e ngastrave të fshatrave për vendbanimin, më 1.8.1991, si dhe për vendbanimin aktual;

iv. lista e përfituesve të tokës bujqësore në vendbanimin e datës 1.8.1991 dhe në vendbanimin aktual;

v. lista me emrat e kryefamiljarëve, që është disponuar gjatë ndarjes së tokës bujqësore në fshat;

vi. të dhënat e regjistrit kadastral, për të evidentuar nëse ka ose jo regjistrime të tjera në favor të përfituesit, mbi bazën e një akti të marrjes së tokës në pronësi.

Nëse nuk provohet plotësimi i këtij kushti, subjektit i lind e drejta të depozitojë një deklaratë noteriale, nëpërmjet së cilës të deklarojë që nuk ka përfituar tokë në territorin e asnjë ish-

kooperative apo ish-ndërmarrjeje bujqësore tjetër, përveç ngastrave, për të cilat ai kërkon të pajiset me aktin e marrjes së tokës në pronësi. Deklarimi i rremë, sipas kësaj pike, përbën shkak për kufizim pa afat të pasurisë dhe, sipas rastit, nëse prona është shtetërore, vënien në dijeni të Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 3, të, nenit 8, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

c) Subjekti, që ka paraqitur kërkesë për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, është përdorues faktik i tokës bujqësore. Për shqyrtimin e këtij kushti, ASHK-ja së bashku me njësinë e vetëqeverisjes vendore verifikojnë, nëse:

i. subjekti ka paguar taksat vendore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore; ose

ii. nga dokumentacioni kadastral që administrohet nga ASHK-ja, në kuadër të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, rezultojnë të dhëna që provojnë se subjekti është përdorues faktik, para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi; ose

iii. nga evidentimi faktik në terren rezulton se subjekti është përdorues faktik i tokës bujqësore.

4.2 Kushtet që duhet të plotësojë toka bujqësore, për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë janë, si më poshtë vijon:

a) T'i përkasë një prej llojeve të tokës bujqësore (arë, pemëtore, vresht dhe ullishte), në momentin e miratimit të vendimit të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore. Për verifikimin e llojit të pasurisë, ASHK-ja i referohet dokumentacionit të administruar nga Drejtoria e Administrimit të Tokës, si: librat e tokës, librat e ngastrave të fshatit, regjistrat apo dokumentacioni ku janë pasqyruar të dhëna dhe tregues për tokën bujqësore apo për kategorinë e resursit të tokës, gjatë periudhës 29 gusht 1945 deri në 19 shtator 1991, hartat kadastrale të afërta me momentin e miratimit të vendimit të kalimit në pronësi, si edhe aktet e organeve publike, nëpërmjet të cilave janë realizuar ndryshime apo kalime të tokës bujqësore në resurse të tjera dhe anasjelltas.

Kur mungon dokumentacioni nga Drejtoria e Administrimit të Tokës, ASHK-ja i referohet dokumentacionit të ndarjes së tokës, të depozituar nga njësia e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet sipërfaqja për të cilën kërkohet pajisja me aktin e kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore.

Nëse rezulton se lloji i tokës, për të cilën kërkohet pajisja me aktin e kalimit në pronësi, ka qenë i ndryshëm nga zërat e tokës bujqësore, refuzohet kërkesa.

b) Toka bujqësore, për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë, të mos jetë në pronësi të të tretëve. Për verifikimin e këtij kushti, ASHK-ja shqyrton:

i. dokumentacionin kadastral të regjistruar, për të verifikuar nëse ka titull të regjistruar në favor të subjektit kërkues;

ii. dokumentacionin e ndarjes së tokës bujqësore të administruar nga struktura e administrimit dhe mbrojtjes së tokës pranë Këshillit të Qarkut dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore (DAMT/ZAMT);

iii. vendimmarrjet për kthim ose kompensim fizik prone, për pasurinë/ngastrën, për të cilën kërkohet pajisja me aktin e kalimit në pronësi të tokës bujqësore.

c) Toka bujqësore, për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë, të mos jetë objekt i formave të kompensimit fizik, sipas ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", të ndryshuar. Për verifikimin e këtij kriteri ASHK-ja i kërkon Agjencisë së Trajtimit të Pronave informacion nëse pasuria/ngastra për të cilën kërkohet pajisja me aktin e kalimit në pronësi të tokës bujqësore, është objekt i formave të kompensimit fizik.

ç) Toka bujqësore, për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë, të mos jetë objekt i investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë. Për verifikimin e këtij kushti, ASHK-ja i kërkon AIDA-s informacion nëse pasuria/ngastra, për të cilën kërkohet pajisja me aktin e kalimit në pronësi të tokës bujqësore, është objekt i investimeve strategjike në Republikën e Shqipërisë.

d) Toka bujqësore, për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë, të mos jetë zënë nga ndërtime pa leje të të tretëve apo të vetë subjektit, gjë që verifikohet gjatë evidentimit në terren dhe nëpërmjet bazës të të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë.

5. Vendimi i kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore është sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ai miratohet në favor të:

a) anëtarëve të familjes, sipas gjendjes familjare të datës 1.8.1991 dhe gjendjes familjare aktuale, për ish-kooperativat bujqësore;

b) anëtarëve të familjes, sipas gjendjes familjare të datës 1.8.1991 me ndryshimet deri në datën 1.10.1992 dhe gjendjes familjare aktuale për ish-ndërmarrjet bujqësore;

c) të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit, që i është marrë toka gjatë reformës agrare, për krijimin e ish-kooperativave bujqësore dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, pavarësisht vendbanimit të tyre në kohën e lëshimit të AMTP-së, për rastet e përcaktuara në nënndarjen "vii", të shkronjës "a", të pikës 4.1, të këtij vendimi.

Nëse ndonjë nga trashëgimtarët ka përfituar AMTP tjetër në bazë të ndonjë cilësie të përcaktuar në nënndarjet "i"–"vi", të shkronjës "a", të pikës 4.1, të këtij vendimi, ai nuk përfiton sipas këtij vendimi. Në këtë rast, akti i kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore për subjektin e shpronësuar (nënndarja "vii", e shkronjës "a", të pikës 4.1, të këtij vendimi), lëshohet në emër të të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit, me përjashtim të personit që ka përfituar tashmë një AMTP në bazë të ndonjë cilësie të përcaktuar në nënndarjet "i"–"vi", të shkronjës "a", të pikës 4.1, të këtij vendimi.

6. ASHK-ja harton listën e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore, mbi bazën e kërkesave të dorëzuara dhe të pranuara nga organet kompetente – njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe sipërfaqet e saktësuara, sipas kreut III, të këtij vendimi.

7. Lista e hartuar nga ASHK-ja përmban të dhëna, mbi:

a) gjenealitetet dhe numrin e identifikimit të përfituesit;

b) numrin, sipërfaqen dhe llojin e pasurisë që kalohet në pronësi pa shpërblim;

c) pasuritë kufitare të pasurisë që kalohet në pronësi pa shpërblim.

8. Lista e përdoruesve dhe paraqitja grafike e parcelave që kërkohet të kalohen në pronësi afishohet për 30 (tridhjetë) ditë kalendarike në ambientet e fshatit, me qëllim që të verifikohen të dhënat nga përdoruesit/përfituesit dhe të paraqesin pretendimet e tyre. Gjatë këtij afati, pretendimet e paraqitura nga përfituesit pasqyrohen në dokumentacionin përfundimtar të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore.

9. Dokumentacioni përfundimtar për miratimin e kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, është:

a) lista e përdoruesve faktikë;

b) planvendosjet e pronave që kërkohen të kalohen në pronësi, të nënshkruara nga përfaqësuesit e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ASHK-ja; dhe

c) relacioni përkatës.

Dokumentacioni përfundimtar, sipas kësaj pike, i paraqitet për miratim këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

10. Këshilli bashkiak vendos sipas nenit 14, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Në rastet kur këshilli bashkiak, me vendim të arsyetuar, vendos rrëzimin e projektvendimit "Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore", ASHK-ja korrigjon përmbajtjen e listës, sipas vërejtjeve të arsyetuara të këshillit bashkiak, të cilën ia riparaqet për miratim këshillit bashkiak.

11. Pas miratimit të vendimit nga këshilli bashkiak, ASHK-ja vijon me miratimin e vendimeve individuale për kalimin e tokës bujqësore në pronësi, pa shpërblim, për përfituesit.

12. Regjistrimi i vendimit individual për kalimin e tokës bujqësore në pronësi, pa shpërblim, kryhet kryesisht nga drejtoria vendore e ASHK-së, vetëm pasi të jetë plotësuar një nga kushtet e mëposhtme:

a) të ketë kaluar afati 30-ditor (tridhjetëditor) i paraqitjes së ankimit administrativ ndaj vendimit dhe ndaj tij nuk është paraqitur ndonjë ankim. Afati i ankimit llogaritet nga data e njoftimit të vendimit; ose

b) të ketë përfunduar shqyrtimi i ankimit nga struktura e posaçme për ankimet në Drejtorinë e Përgjithshme dhe vendimi të jetë lënë në fuqi, ose të jetë vendosur mospranimi i ankimit; ose

c) në rastet kur struktura e posaçme për ankimet vendos për ndryshimin e përmbajtjes së vendimit të drejtorisë vendore ose shfuqizimin apo anulimin e pjesshëm të tij, regjistrimi kryhet pasi drejtoria vendore të ketë miratuar vendimin e ri për dokumentin e pronësisë, në bazë të aktit të strukturës së posaçme.

13. Regjistrimi kryhet nga drejtoria vendore e ASHK-së, pa u kushtëzuar nga aplikimi për shërbim kadastral dhe nga parapagimi i tarifave kadastrale. Pas kryerjes së shërbimit të regjistrimit, drejtoria vendore njofton subjektin përfitues për të shlyer tarifën e regjistrimit dhe tarifat e tjera për t'u pajisur me aktet kadastrale, si: certifikatë regjistrimi pronësie, kopje kartele, kopje të fragmentit të hartës kadastrale.

III. SAKTËSIMI I SIPËRFAQES PËR KALIM PRONËSIE

14. Procesi i saktësimit të sipërfaqes dhe pozicionit gjeografik të tokës për kalim pronësie kryhet në bashkëpunim me përfaqësuesit e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të ASHK-së. Për këtë qëllim, bëhet verifikimi në terren i ngastrave të pretenduara. Gjatë këtij procesi verifikohet pozicioni faktik i ngastrës që posedohet dhe sipërfaqes që posedohet në fakt. ASHK-ja harton planin e rilevimit, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesit e saj dhe përfaqësuesit e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore.

14.1 Për zonat kadastrale pa regjistrim fillestar, procesi i lëshimit të akteve të kalimit të tokës bujqësore në pronësi kryhet pas përfundimit të konsultimit publik, sipas nenit 31, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën".

14.2 Për zonat kadastrale me regjistrim fillestar që kanë nevojë për përmirësim të regjistrimit fillestar, procesi i lëshimit të akteve të kalimit të tokës bujqësore në pronësi kryhet pas përfundimit të procesit të përmirësimit. Për zonat kadastrale me regjistrim fillestar dhe që nuk kanë nevojë për përmirësim, procesi i lëshimit të akteve të kalimit të tokës bujqësore në pronësi kryhet si rregull me blloqe kadastrale.

15. Sipërfaqja e tokës bujqësore, që kalohet në pronësi pa shpërblim, është sipas rastit:

a) Sa sipërfaqja e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës në përdorim ose në dokumentacionin e ndarjes së tokës. Nëse sipërfaqja e lirë në terren është më e vogël se ajo e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës në përdorim apo aktet e ndarjes së tokës bujqësore, subjektit i miratohet kalimi i pronësisë, pa shpërblim, vetëm për sasinë e sipërfaqes që rezulton e lirë. Nëse subjekti posedon sipërfaqe më të madhe se ajo e përcaktuar sipas aktit të marrjes së tokës në përdorim ose akteve të ndarjes së tokës, për sipërfaqen shtesë zbatohen për analogji përcaktimet e pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe të aktit nënligjor në zbatim të pikës 9, të po këtij neni.

b) Sa normativa që llogaritet nga raporti i sipërfaqes aktuale që rezulton e lirë në territorin e fshatit, në raport me numrin e frymëve në fshat, në momentin e miratimit të vendimit për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore.

Sipërfaqe e lirë konsiderohet ajo, e cila gjatë regjistrimit fillestar ose pas përmirësim/përditësimit rezulton se plotëson kushtet e pikës 4.2, të këtij vendimi.

c) Sa sipërfaqja e përcaktuar ndërmjet marrëveshjes noteriale të përfituesve të tokës bujqësore. Marrëveshja noteriale ndërmjet përfituesve të tokës bujqësore, kufitarë, duhet të depozitohet pranë ASHK-së, para fillimit të afatit të parashikuar në pikën 8, të këtij vendimi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

16. Janë objekt trajtimi, sipas këtij vendimi, edhe ato raste kur subjekti kërkues nuk e përdor tokën, për arsye se organet që në bazë të vendimit të gjykatës së formës së prerë, detyroheshin të pajisnin qytetarin me tokë, por nuk e kanë zbatuar atë.

17. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 6.3.2013, "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat

e ish-kooperativave bujqësore", të ndryshuar, dhe nr. 337, datë 22.4.2015, "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar, shfuqizohen.

18. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA_____

VENDIM

Nr._____, datë_____

PËR
KALIMIN/REFUZIMIN E KALIMIT NË PRONËSI PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE

Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____, "Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore", u mor në shqyrtim kërkesa e _____ për kalimin në pronësi të tokës bujqësore me vendndodhje: Bashkia:_____ .

Parashtrimi i fakteve: (Këtu do të listohen)

a) Shpjegimet e situatës faktike parcelës, si: adresa, numri i pasurisë, zona kadastrale, sipërfaqja e parcelës, sipas verifikimeve në terren; mënyrën e përcaktimit të sipërfaqes që kalohet në pronësi referuar normativës së përcaktuar etj.

b) Situata ligjore në raport me kriteret për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, legjitimiteti i kërkuesit, kushtet e ngastrës/ngastrave që do të kalohet etj.

c) Dokumentacioni i administruar nga institucionet apo subjekti (me referencat) dhe veprimet administrative e dokumentacionit të hartuar nga ASHK-ja, në kuadër të procedurave të legalizimit, shpjegime mbi vlerësimin e provave.

Vlerësimi dhe arsyetimi ligjor: (Shpjegimet mbi shkaqet ligjore të kalimit ose refuzimit të kalimit të tokës në pronësi).

Në përfundim, drejtoria vendore e ASHK-së _____, pasi verifikoi gjendjen faktike të ngastrës/ngastrave, analizoi dokumentacionin dhe faktet, si dhe verifikoi plotësimin/mosplotësimin e kritereve ligjore nga ngastra/ngastrat, bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës __, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.____, datë _____, "Për miratimin e

rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore",
[1]

VENDOSI:

1. Kalimin/refuzimin e kalimit në pronësi të ngastrës me vendndodhje _____, nr. pasurie _____, dhe sipërfaqe_____, në favor të _____.

2. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim, sipas nenit 66, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Procedurave Administrative.

3. (Kjo dispozitë bëhet pjesë e vendimit në rastin e kalimit të pronësisë) - Ky vendim regjistrohet pas kalimit të afatit 30-ditor nga data e njoftimit të tij, në rastin e mosankimit administrativ ose pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit të ankimit nga struktura përgjegjëse për ankimet pranë Drejtorisë së Përgjithshme; ose

4. Vendimi u njoftohet subjekteve të interesuara brenda 10 ditëve nga data e miratimit.

DREJTOR

_____

Vendimi për kalimin e tokës bujqësore në pronësi pa shpërblim përgatitet në 4 kopje origjinale, të cilat u përcillen përfituesve, njësisë së vetëqeverisjes vendore, drejtorisë së administrimit dhe menaxhimit të tokës pranë Këshillit të Qarkut dhe 1 (një) kopje mbetet pranë drejtorisë vendore të ASHK-së. Vendimi shoqërohet me planvendosje të ngastrës/vetëpërfituar. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim, sipas nenit 66, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe Kodit të Procedurave Administrative.